



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 korrik 2016
Nr. ref.:RK964/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet nr. KI10/15 dhe KI12/15

Parashtrues

Shpresim Uka dhe Bekim Syla

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme Pml. Kzz 98/2014, të 3 shtatorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI10/15 është dorëzuar nga z. Shpresim Uka nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i parë i kërkesës), i cili përfaqësohet nga avokati z. Betim Shala nga Prishtina.

2. Kërkesa KI12/15 është dorëzuar nga z. Bekim Syla nga fshtati Bresje, komuna e Fushë Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i dytë kërkesës), i cili përfaqësohet nga avokati z. Ali Beka nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë të njëjtin Aktgjykim të Gjykatës Supreme Pml. Kzz. 98/2014, të 3 shtatorit 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të parë të kërkesës më 9 tetor 2014, ndërsa parashtruesit të dytë më 11 tetor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës KI10/15 dhe KI12/15 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat the liritë e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Parashtruesit, gjithashtu, kërkojnë nga Gjykata që të mbajë një seancë dëgjimore.

Baza juridike

6. Kërkesat bazohen në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 29 dhe 39 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 2 shkurt 2015, parashtruesi i parë e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 5 shkurt 2015, parashtruesi i dytë e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
9. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës në rastin KI10/15 caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
10. Më 12 mars 2015, Kryetari, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës së Gjykatës, vendosi që ta bashkojë kërkesën KI12/15 me kërkesën KI10/15.

11. Më 30 mars 2015, Gjykata i njoftoi të dy parashtruesit për bashkimin e kërkesave dhe ua dërgoi nga një kopje të kërkesave të bashkuara Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Prokurorit Special (në tekstin e mëtejme: PPS).
12. Më 1 korrik 2015, Kryetarja vendosi ta zëvendësojë gjyqtarin Kadri Kryeziu, mandati i të cilit kishte skaduar, me gjyqtarin Ivan Čukalović si anëtar të Kolegjit shqyrtues.
13. Më 17 maj 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 29 korrik 2011, PSK ngriti aktakuzë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë [PPS 460/09] kundër parashtruesve të kërkesës me pretendimin se kishin kryer veprat penale.
15. Më 17 dhjetor 2012, atëherë Gjykata e Qarkut në Prishtinë [Aktgjykimi P592/11] i shpalli parashtruesit fajtor për kryerjen e veprave penale të tentim vrasjes së rëndë dhe tentim kidnapimit.
16. Më 21 mars 2013 dhe më 25 mars 2013, parashtruesi i parë dhe parashtruesi i dytë parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe kodit penal, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
17. Më 26 prill 2013, PPS parashtroi përgjigje ndaj pretendimeve në ankesë të të dy parashtruesve të kërkesës, duke deklaruar se *“aktgjykimi i kontestuar është plotësisht i kuptueshëm, i qartë dhe preciz”*.
18. Më 12 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit [Aktgjykimi PAKR 102/13] vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, duke i shpallur fajtor të dy parashtruesit e kërkesës për vrasje të rëndë dhe parashtruesin e parë për vrasje të rëndë në tentativë.
19. Më 15 maj 2014 përkatësisht më 2 qershor 2014, parashtruesi i parë dhe parashtruesi i dytë parashtruan kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave përkatëse të kodit të procedurës penale dhe shkelje të kodit penal.
20. PPS parashtroi përgjigje ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë duke pohuar se *“kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike”*, dhe se *“argumentet janë identike me ato të ngritura në ankesën kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut. Ato tashmë janë adresuar dhe refuzuar nga Gjykata e Apelit”*
21. Më 3 shtator 2014, Gjykata Supreme [Aktgjykimi Pml. Kzz 98/2014] i refuzoi si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, sepse nuk mundi të gjejë *“asnjë kontradiktë në mes të dispozitivit dhe arsytimit të asnjërit prej aktgjykimeve”* dhe *“nuk ka pasur shkelje të dispozitave të ligjit penal.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës së parë dhe të dytë janë plotësisht identike. Kështu, Gjykata do t'i vlerësojë ato së bashku.
23. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimet e gjykatave të rregullta janë shkelur të drejtat për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mjete juridike, dhe për mbrojtje gjyqësore të të drejtave.
24. Të dy parashtruesit e kërkesës gjithashtu konsiderojnë se gjykatat e rregullta e kanë shkelur parimin *in dubio pro reo*.
25. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata “të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore” dhe “të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të të dy parashtruesve”.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesat KI10/15 dhe KI12/15 i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me ligj dhe me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] së Ligjit, i cili parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij/saj të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar, dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

29. Gjykata më tej rikujton rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

30. Gjykata gjithashtu përmend edhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

31. Në të vërtetë, Gjykata rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) përcaktoi se *“është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale”* (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-1”).
32. Gjykata përsërit se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, shih po ashtu *mutatis mutandis* rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
33. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e gjendjes faktike ose të ligjit të zbatueshëm që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, gjatë vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërisë) përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).
34. Prandaj, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës duhet të parashtrojnë pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës kur pretendojnë se autoriteti publik i ka shkelur të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese.
35. Gjykata thekson po ashtu se detyrë e Gjykatës është të vlerësojë nëse procedurat përkatëse të gjykatave të rregullta në lidhje me kërkesat KI10/15 dhe KI12/15 ishin të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ose që kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009; *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991; *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, nr. 10588/83, 10589/83, 10590/83, para. 68).
36. Gjykata vëren se parashtruesit konsiderojnë se në procedurën penale të kryer në gjykatat e rregullta, ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Parashtruesi i parë, në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, theksoi se *“të dy aktgjykimet kanë bërë shkelje*

substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 dhe shkelje të ligjit penal sipas nenit 385(1) të KPPK-së”, siç specifikohet më tej në Aktgjykimin e kontestuar. Parashtruesi i dytë i kërkesës theksoi se “të dy aktgjykimet janë në shkelje të nenit 403 të KPPK-së, dhe në shkelje të Ligjit Penal sipas nenit 404 të KPPK-së”, siç specifikohet më tej në Aktgjykimin e kontestuar.

37. Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka vërejtur se një numër i madh i çështjeve të ngritura nga parashtruesit “janë çështje që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave” dhe se “kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 432 i KPPK).”
38. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konsideron se Aktgjykimi i shkallës së parë “është tejet i hollësishëm dhe i qartë sa i përket asaj që saktësisht është gjetur si e vërtetuar-përsëri, kjo është detajuar në mënyrë tërësisht gjithëpërfshirëse”, dhe se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit “është po ashtu i artikuluar në arsyetimin e tij dhe plotësisht i qartë sa i përket gjetjeve të tij”.
39. Në fund, Gjykata Supreme nuk kishte gjetur “asnjë arsye që të diskutojë më tutje pretendimet tjera të paraqitura në kërkesa sepse ato janë qartazi të pretendime të pabazuara (...) dhe në pjesën më të madhe tashmë të përmendura në aktgjykime”.
40. Në përgjithësi, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme tërësisht analizoi dhe iu përgjigj pretendimeve të bëra nga parashtruesit në ankesën e tyre, që kanë të bëjnë me çështjet e ligjshmërisë.
41. Gjykata vëren se Gjykata Supreme vuri në dukje se “fatkeqësisht është një tendencë e përhapur gjerë në mesin e shumë avokatëve mbrojtës që të përdorin kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si ankesë të dytë, gjë që nuk do të duhej të ndodhte”. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata vëren se shumë parashtrues përdorin kërkesën në Gjykatën Kushtetuese sikur ajo të ishte “gjykatë e shkallës së katërt”.
42. Përveç kësaj, Gjykata rikujton se parashtruesit pretendojnë shkelje të së drejtës së tyre për barazi para ligjit (i), për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (ii), për mjete juridike (iii) dhe për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave (iv). Ata kërkojnë që Gjykata të mbajë një seancë dëgjimore (v).
43. Gjykata, pasi ka identifikuar çështjen kryesore të analizës kushtetuese, rikujton se, në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, është e detyruar që të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në pajtim me vendimet e GJEDNJ-së.

(i) Shkelja e së drejtës së tyre për barazi para ligjit

44. Gjykata merr parasysh nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës i cili përcakton:

(...)

“2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”

45. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se nuk është e mjaftueshme që parashtruesit t'i referohen në përgjithësi një trajtimi të pabarabartë për të vërtetuar diskriminimin, pa treguar bazën e kësaj pabarazie. Gjykatat e rregullta kompetente kanë kryer procedurat në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme dhe kanë gjetur se të dy parashtruesit kanë kryer veprën penale për të cilën ishin akuzuar dhe atyre u është shqiptuar dënimi.
46. Gjykata Kushtetuese me tej konsideron se procedurat e kryera dhe dënimi i shqiptuar ndaj parashtruesve nuk ishin mbajtur dhe vendosur në bazë të diskriminimit të përmendur me nenin 24.2 të Kushtetutës.
47. Në të vërtetë, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila thekson se *“diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata të ngjashme”* (shih Aktgjykimin: *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36042/97, paragrafi 48, GJEDNJ, 2002- IV, Aktgjykimi: *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, Aktgjykimi: *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, paragrafi 44).
48. Gjykata konsideron se parashtruesit kishin pasur qasje të barabartë dhe mbrojtje të të drejtave të tyre në të gjitha shkallët e gjykatave të rregullta. Ata nuk kanë dëshmuar dhe vërtetuar shkeljen e të drejtave të tyre në bazë të diskriminimit. Prandaj, pretendimet e tyre për pabarazi para ligjit janë të pabazuara.

(ii) Shkelja e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

49. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] përcakton:

“(…)

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm (...) për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

“(…)

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin”.

50. Para së gjithash, Gjykata thekson se e drejta themelore për gjykim të drejtë rrjedh nga e drejta për mbrojtje gjyqësore, e garantuar me nenin 54 të Kushtetutës. Më shumë se të drejtat e tjera themelore, e drejta për gjykim të

drejtë kërkon që gjyqtarët të jenë të kujdesshëm, pasi ata janë gjithmonë në rrezik për ta shkelur atë. Në të vërtetë, e drejta për gjykim të drejtë është një referencë e përgjithshme për një kompleks të të drejtave të tjera: përkatësisht, e drejta për qasje në gjykata, për të paraqitur argumente dhe prova, për vendim të arsyetuar dhe e drejta për kundërshtim dhe parimi i barazisë së armëve.

51. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se aktgjykimet e kontestuar tregojnë një analizë të plotë dhe të gjerë të të gjitha fakteve dhe ligjit në lidhje me kryerjen e veprave penale dhe caktimin e dënimit.
52. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka shpjeguar në detaje dhe i është përgjigjur ankesës së parashtruesve, duke ofruar përgjigje në pretendimet për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, si dhe për “*shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 dhe shkelje të ligjit penal sipas nenit 385 (1) të KPPK-së*”, si dhe për shkelje të “*nenit 403 të KPPK-së, dhe në shkelje të Ligjit Penal sipas nenit 404 të KPPK-së.*”
53. Gjykata e Apelit aprovoi pjesërisht pretendimet ankimore të parashtruesit të dytë të kërkesës në pjesën në lidhje me kohëzgjatjen e dënimit të shqiptuar dhe gjithashtu kishte përfshirë edhe kohën e kaluar në paraburgim. Për më tepër, Gjykata e Apelit mori parasysh zbatimin e ligjit më të favorshëm penal.
54. Përveç kësaj, Gjykata vëren se gjetjet e Aktgjykimit të kontestuar me rastin e vlerësimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, shqyrtoi plotësisht gjetjet e tij të përgjithshme, dispozitivin dhe bazën e aktgjykimit, dëshmitarin bashkëpunues dhe provat mbështetëse, provat e reja në Gjykatën e Apelit, parimin *in dubio pro reo*, llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim, dhe pretendimet e tjera. Ajo përfundoi, duke refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.
55. Gjykata vëren se vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë nga një gjykatë e themeluar në baza kushtetuese dhe ligjore, duke vendosur në seancën e kolegjit në kuadër të përbërjes së caktuar, duke vepruar brenda kufijve të juridiksionit të saj dhe në pajtim me ligjet në fuqi.
56. Gjykata konsideron se në aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë marrë parasysh pretendimet e bëra në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, brenda kufijve të caktuar me ligj, janë shpjeguar në mënyrë të detajuar të gjitha pretendimet dhe është arsyetuar pse janë refuzuar kërkesat si të pabazuara. Shpjegimet e paraqitura dhe arsyet nuk janë rezultat i vërtetimit të paarsyeshëm të fakteve apo zbatimit arbitrar të së drejtës procedurale dhe materiale.
57. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se gjykatat e rregullta kanë shkelur parimin *in dubio pro reo*, për shkak se ato nuk kanë interpretuar dyshimet e pretenduara në prova në favor të tyre, sepse ato e kishin formuar mendimin për fajin e tyre para fillimit të gjykimit dhe pastaj janë përpjekur t'i interpretojnë të gjitha provat në këtë drejtim.
58. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta bazuan rezultatin e procedurave në vlerësimin veç e veç dhe të përbashkët të provave të paraqitura,

me të cilat përcaktuan faktet vendimtare për nxjerrjen e vendimit për përgjegjësi penale dhe sanksion penal.

59. Përveç kësaj, në aktgjykimin e kontestuar tërësisht shtjellohet çështja e parimit *in dubio pro reo*, tejkalimi i përkufizimit të tij ligjor, keqkuptimi i zakonshëm i ushtrimit të parimit, përmbajtja thelbësore e parimit dhe pse nuk është shkelur parimi *in dubio pro reo*.
60. Gjykata rikujton se është përtej juridiksionit të saj që të vlerësojë cilësinë e konkluzioneve të gjykatave lidhur me vlerësimin e provave, përveç nëse ato janë haptazi arbitrare. Gjykata Kushtetuese nuk ndërhyt as në mënyrën se si gjykatat kanë pranuar provat si material dëshmuar dhe nuk ndërhyt në diskrecionin e gjykatës në vlerësimin e vlerës dëshmuar. Ky është rol ekskluziv i gjykatave të rregullta, madje edhe kur deklaratat e dëshmitarëve në shqyrtimin publik dhe nën betim janë në kundërshtim (Shih Gjykata Evropiane *Doorson kundër Holandës*, Aktgjyrimi i 6 marsit 1996, i publikuar në Raportin nr. 1996-II, paragrafi 78).
61. Gjykata konsideron se aktgjyrimi i kontestuar bazohet në procedurat e kryera në pajtim me dispozitat ligjore dhe me respektimin e të drejtave dhe lirive të parashtruesve të kërkesës të mbrojtura me Kushtetutë.
62. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesit nuk e kanë shpjeguar me saktësi se si dhe pse aktgjyrimi i kontestuar u ka shkelur të drejtën e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe se ata nuk e kanë dëshmuar dhe mbështetur pretendimin e tyre mbi baza kushtetuese.

(iii) Shkelja e së drejtës për mjete juridike

63. Gjykata rikujton se parashtruesit gjithashtu pretendojnë shkelje të së drejtës së tyre për mjete juridike. Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i Kushtetutës përcakton:

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

64. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit kanë pasur mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tyre në Gjykatën e Qarkut, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Shkeljet e pretenduara të së drejtës materiale dhe procedurale janë trajtuar gjerësisht dhe tërësisht nga gjykatat e rregullta.
65. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se GJEDNJ ka vendosur standardet në atë se çfarë përbën një mjet efektiv juridik. Këto standarde në parim nuk kërkojnë që çdo pretendim i ngritur nga një parashtrues duhet të shqyrtohet. Ajo që është më e rëndësishme, këto standarde nuk duhet të përkthehen ashtu që të nënkuptojnë se një mjet efektiv juridik është ai i cili dëshmohet të jetë i suksesshëm për parashtruesin e kërkesës. Përkundrazi, ky nuk është një kusht i cili kërkohet as nga KEDNJ, dhe as nga Kushtetuta.

66. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se GJEDNJ konstatoi se *“efektiviteti i një mjeti brenda kuptimit të nenit 13 të Konventës Evropiane [që korrespondon me nenin 32 të Kushtetutës] nuk varet nga siguria e një rezultati të favorshëm të procedurës për parashtruesin e kërkesës”* (Aktgjykimi *Gebremedhin kundër Francës*, nr. 25389/05, § 53).
67. Kjo do të thotë se kur ndërtohet një rast në Gjykatën Kushtetuese nuk është e mjaftueshme që parashtruesit t'i referohen një shkeljeje të nenit 32 të Kushtetutës ose të nenit 13 të KEDNJ-së, vetëm për shkak se gjykatat nuk i kanë pranuar si të bazuara pretendimet mbi të cilat ata i bazuan ankesat e tyre, dhe kryesisht kur ankesat nuk ishin të favorshme për parashtruesit e kërkesës.
68. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë pasur qasje në mjetet juridike në të gjitha shkallët e procedurës dhe se e drejta për mjet efektiv juridik është respektuar. Parashtruesit e kërkesës gjatë procedurës kanë mundur të parashtrojnë kundërshtim ndaj aktakuzës, kualifikimit ligjor të veprës penale dhe të parashtrojnë ankesa kundër vendimeve. Në të vërtetë, ata parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit dhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.
69. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruara nga parashtruesit e kërkesës janë shqyrtuar plotësisht dhe ishte vendosur që nuk ishte bërë asnjë shkelje e së drejtës procedurale dhe materiale. Fakti se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me konkluzionin e Gjykatës së Apelit apo të Gjykatës Supreme nuk e bën mjetin e tillë joefektiv.

(iv) Shkelja e së drejtës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave

70. Gjykata rikujton se parashtruesit gjithashtu pretendojnë shkelje të së drejtës së tyre për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave. Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës përcakton:

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

71. Gjykata rikujton se nga neni 54 i Kushtetutës rrjedh se kushti për realizimin e së drejtës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave është shkelja apo mohimi i ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë. Nëse ka një shkelje të tillë, bartësi i së drejtës së shkelur ose të mohuar ka të drejtë pasuese në mjete efektive juridike.
72. Gjykata sapo ka konkluduar se pretendimi i parashtruesve për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është i pabazuar dhe e se e drejta për mjet efektiv juridik është respektuar. Prandaj, nuk ka shkelje të të drejtave që çojnë në mbrojtjen gjyqësore dhe në mjete efektive juridike. Rrjedhimisht, nuk ka objekt për shqyrtim kushtetues.

73. Prandaj, Gjykata konstaton se nuk ka bazë për të shqyrtuar pranueshmërinë e pretendimit të parashtruesve për shkeljen e të drejtës së tyre për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave sipas nenit 54 të Kushtetutës.
74. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre dhe as nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues: *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA nr. 1947/2013 të 5 dhjetorit 2013).
75. Gjykata konsideron se kërkesat e parashtruesve nuk i kanë plotësuar kushtet e caktuara me Kushtetutë, siç parashihen më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
76. Prandaj, kërkesat e parashtruesve janë qartazi të pabazuara dhe duhet të deklarohen të papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

(v) Kërkesa për të mbajtur seancë dëgjimore

77. Gjykata rikujton se parashtruesit kërkojnë nga Gjykata “*të urdhëroj mbajtjen e seancës dëgjimore*”. Neni 20 i Ligjit parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.”

78. Gjykata vëren se parashtruesit thjesht kërkojnë një seancë dëgjimore, pa kurrfarë faktesh dhe arsyetimesh.
79. Gjykata konsideron se shkresat e lëndës janë të mjaftueshme për të vendosur për kërkesat, në pajtim me nenin 20.2 të Ligjit.
80. Prandaj, kërkesat e parashtruesve për të mbajtur shqyrtim verbal refuzohen.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, më 17 maj 2016, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për seancë dëgjimore;
- III. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi